



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 4 datë 5.1.2022

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESEM 2023-2025 DHE BUXHETIT VJETOR 2023”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 5.1.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 të miratuar më datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar nën ligjit nr. 68/2017 datë “Per financat e qeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018 “Per procedurat standarte të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesem të njesive të qeverisjes vendore”, udhëzimi nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër:

VENDOSI:

1. Miratimin e Kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023, sipas lidhjes nr. 1, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Llesha

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 10.1.2022

LIDHJA NR. 1: KALENDARI I PERGATITJES SE PBA 2023-2025

I

KALENDARI PBA & BUXHETIT VJETOR

- Përgatitet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe i propozohet më tej Këshillit të njësisë;
- Miratohet nga këshilli i njësisë (brenda 31.12. viti 2021);
- Hyn në fuqi dhe shpërndahet te të gjitha njësitet shpenzuese nga kryetari i njësisë (1.01.2022);

II

VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

- Kryetari paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill (brenda 31.01. viti 2022);
- Këshilli miraton raportin e vlerësimeve (1.03. viti 2022);

III

TAVANET E SHPENZIME VE TË PBA NË NIVEL PROGRAMI

- Kryetari i njësisë propozon tavanet përgatitore për miratim në këshill (1.03. viti 2022);
- Këshilli miraton tavanet përgatitore (15.03. viti 2022);
- Kryetari i njësisë miraton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit (5 ditë nga miratimi i tavaneve);
- Udhëzimi shpërndahet te njësitet shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavaneve / 20.03. viti 2022);
- Tavanet përfundimtare paraqiten nga kryetari i njësisë në këshill (korrik viti 2022);
- Këshilli miraton tavanet përfundimtare (20.07.viti 2022);
- Kryetari i njësisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë dhe e shpërndan te të gjitha njësitet shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavaneve përfundimtare / 25.07. viti 2022);

KALENDARI I PËRGATITJES SE PBA 2023-2025

IV

KËRKESAT SIPAS TAVANEVE

- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavaneve përgatitore të Njësia e Menaxhimit të Programeve (prill.viti t) dhe japin argumente për fonde/tavane shtesë;
- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavaneve përfundimtare (1.08. viti 2022);

V

PBA & BUXHETI VJETOR

- Kryetari i njësisë përgatit dokumentin I të PBA viti t+1, t+2, t+3 (30.05.2022)
- Kryetari i njësisë dërgon MFE PBA (1.06. viti 2022);
- MFE-ja dërgon opinionion e saj mbi PBA-në të njësia vendore (20.06. viti 2022);
- Kryetari i njësisë vendore dërgon PBA-në së bashku me opinion e MFE-së për miratim në Këshill (21.06. viti 2022);
- Këshilli i njësisë vendore miraton dokumentin e parë të PBA-së (30.06. viti 2022);
- Kryetari publikon PBA / dokumentin I (5.07 viti 2022);
- MFE-ja nxjerr udhëzimin plotësues për rishikimin e PBA-së (10. korrik viti 2022);
- Njësia rishikon PBA-së (korrik - gusht viti 2022);
- Njësia organizon takime konsultuese (1-15.09. viti 2022);
- Njësia dërgon PBA-në e rishikuar të MFE-ja 15.09.2022;
- MFE-ja zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore (5.10.2022);
- MFE-ja dërgon opinionin përfundimtar sipas rastit të njësia vendore (20.10.2022);
- Kryetari i bashkisë paraqet për miratim në Këshill PBA-në dhe buxhetin vjetor përfundimtar (30.11.2022);
- Këshilli miraton PBA-në dhe buxhetin vjetor (25.12.2022);
- Kryetari i njësisë publikon PBA-në dhe buxhetin vjetor dhe materialet shoqëruese (31.12.2022);